



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHDI
KËSHILLI BASHKIAK

**Raporti për 6-mujorin e parë
mbi realizimin e buxhetit të vitit 2025 planifikuar për Këshillin Bashkiak
Librazhd**

Në funksion të mbarëvajtjes së punës së Këshillit Bashkiak të Librazhdit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025, janë realizuar një sërë shpenzimesh të planifikuara në buxhetin vjetor të bashkisë. Këto shpenzime lidhen me pagesat e anëtarëve të këshillit, funksionimin administrativ dhe përmirësimin e kushteve të punës.

1. Pagesat për këshilltarët bashkiakë

- **Plani vjetor për periudhën:** 11,700,000 lekë
- **Shpenzimi real (fakti) për periudhën Janar-Qershor :** 6,883,069 lekë
Pagesat janë realizuar në përputhje me pjesëmarrjen aktive të këshilltarëve në mbledhjet periodike .

2. Shpenzime për kancelari dhe pajisje zyre

- **Plan:** 250,000 lekë
- **Fakt:** 80,000 lekë
Janë përfshirë blerje materialesh kancelarike, furnizime për sallën e mbledhjeve, toner printeri, letër, si dhe mjete ndihmëse për përgatitjen e dokumentacionit të mbledhjeve.

3. Paga e Sekretarit të Këshillit

- **Plan:** 2,161,992 lekë
- **Fakt:** 1,080,996 lekë
Pagesa është realizuar në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me kontratën individuale të punës.

4. Shërbime të tjera të ngjashme (logjistikë, IT, mbështetje teknike)

- **Plan:** 50,000 lekë
- **Fakt:** 20,000 lekë
Janë mbuluar shpenzime për shërbime teknike gjatë mbledhjeve, mirëmbajtje të pajisjeve IT, si dhe përkthim dhe përpunim i dokumenteve për përdorim publik.

5. Investim në përmirësimin e infrastrukturës – Blerje kondicioneri

- **Plan:** 70,000 lekë
- **Fakt:** 0 lekë

Në kuadër të përmirësimit të kushteve të punës, është parashikuar blerja dhe vendosja e një kondicioneri të ri, për të siguruar mjedis të përshtatshëm pune.

Përmbledhje e përgjithshme e shpenzimeve (janar–qershor 2025)

Zëri i shpenzimit	Plan (lekë)	Fakt (lekë)
Pagesa këshilltarëve	11,700,000	6,883,069
Kancelari dhe pajisje zyre	250,000	80,000
Paga e sekretarit të këshillit	2,161,992	1,080,996
Shërbime të tjera të ngjashme	50,000	20,000
Blerje kondicioneri	70,000	
Totali	14,232,992	8,064,065

Vlerësim dhe rekomandime

Shpenzimet për periudhën janar–qershor janë kryer në përputhje me planifikimin buxhetor dhe tregojnë një menaxhim të kujdesshëm të fondeve publike. Rekomandohet që edhe në vijim të vitit, të ruhet ky standard i kontrollit financiar dhe transparencës përballë komunitetit.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Elson Malluta

